



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 28.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EOR Group Shpk" për aktivitetin: "**Furnizim dhe montim me paisje për institucionet vartese të Drejtorise për Kulture**" dhe me numër të prokurimit: 616 20 124 121 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "EOR Group Shpk" e datës 26.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim dhe montim me paisje për institucionet vartese të Drejtorise për Kulture**" me Nr. 616-20-5025-1-2-1, me Nr. Brendshëm : 616 20 124 121 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *kete aktivitet ta kthej ne rivleresim.*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "EOR Group Shpk" me datë 26.10.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim dhe montim me paisje për institucionet vartese të Drejtorise për Kulture**" me numër të prokurimit Nr. 616-20-5025-1-2-1 dhe numër të brendshëm 616 20 124 121 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 28.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi për nderhyrje-ndryshim të pershkrimit në pozicionin nr.1 të OE-ik të rekomanduar për kontratë është i bazuar pasi që është konstatuar se në ofertën e tij ka një pershkrim tjetër nga ai që ka dhënë AK.

Bazuar në këtë rekomandim që aktiviteti të kthehet në rivleresim.

Shtojce: Bashkengjitur raporti i komisionit profesional.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit